



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:141750  
Datë: 29.08.2024  
Numri i dokumentit: 06101348

**C.nr. 1126/22.**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Migjen Kastrati, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit P.D nga Deçani të cilinë sipas autorizimit e përfaqëson Faruk Binakaj, avokat në Pejë, kundër të paditurës Kompania e SigurimeveE, me seli në Prishtinë, baza juridike, kompensim i dëmit sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1,000.00 €, gjykata jashtë seancës, me datën 29.08.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET SI E TËRHEQUR** padia e datës 13.07.2022 me numër C.nr. 1126/22 e paditësit, P.D nga Deçani, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve E, me seli në Prishtinë, baza juridike, kompensim i dëmit sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1,000.00 €.

**II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë.

**III.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi përmes të autorizuarit të tij me datën 13.07.2022, ka parashtruar padi kundër të paditurës, me bazën juridike, kompensim i dëmit sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1,000.00 €. Me parashtrësën e datës 29.08.2024 i autorizuari i paditësit Faruk Binakaj, avokat nga Peja, ka bërë tërheqjen e padisë për lëndën C.nr.1126/22, me arsyetimin se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, duke i propozuar gjykatës që të lejoj tërheqjen e padisë. E paditura me parashtrësën e datës 20.09.2022. E paditura me parashtrësë e ka njoftuar gjykatën se për këtë lëndë janë duke u zhvilluar dy lende njëkohësisht andaj kane kërkuar që të veprohet konforme dispozitave ligjore.

Sipas dispozitave ligjore nga neni 261 par. 1,2,3,4,5 të LPK-së, shprehimisht është përcaktuar se: “pala paditëse ka të drejtë ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri të paraqet përgjigjen në padi, padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë. Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë. Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk

është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri”, u vendos si në piken **I** dhe **II** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore - LPK-së, si në piken **III** të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet ligjore komform dispozitave ligjore nga neni 261 e lidhur me nenin 387 par.1 pika ‘c’ dhe nenit 142.1 të LPK, duke vendosur si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2022:141750, C.nr. 1126/22 i dt. 29.08.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Migjen Kastrati**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa në kuptim të dispozitës së nenit 261 par. 4 të LPK- së.